



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 10.11.2023

Në bazë të nenit 42, 47, 48, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, kushteve të konkursit për pranimin e studentëve në nivelin master ref. nr. 2782/23, të dt. 27.09.2023 dhe konkursit për pranimin e studentëve në nivelin master ref. nr. 3046/23, të dt. 19.10.2023, pas shqyrtimit të propozimeve nr. 3114/23, të dt. 30.10.2023 dhe ref. nr. 3201/23, të dt. 07.11.2023, të komisionit për ankesave të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24, në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtura më dt. 10.11.2023, nxjerrë këtë:

V e n d i m

Fakulteti Juridik

- I. **Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatit z. Astrit Krasniqi, ref. nr. 753/23, kundër rezultateve të shpallura më dt. 30.10.2023, për pranimin e studentëve në nivelin master, drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane në Fakultetin Juridik;
- II. **Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatës znj. Arlinda Krasniqi, ref. nr. 821/23, kundër rezultateve të shpallura më dt. 30.10.2023, për pranimin e studentëve në nivelin master, drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane në Fakultetin Juridik;

Fakulteti i Arteve

- I. **Aprovohet** kërkesa e kandidatës znj. Flutra Kasapolli, ref. nr. 214/23, për pranim në nivelin master, drejtimi Edukim Muzikor, në Fakultetin e Arteve, në vitin akademik 2023/24;
- II. **Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatit z. Uran Abazi, për pranim në nivelin master, drejtimi Edukim Muzikor, në Fakultetin e Arteve, në vitin akademik 2023/24;

A r s y e t i m

Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.11.2023, duke u bazuar në propozimin e komisionit për ankesa të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24, ref. nr. 3201/23, të dt. 07.11.2023, i cili pas rikontrollit të testeve ka konstatuar se kandidatët z. Astrit Krasniqi dhe znj. Arlinda Krasniqi nuk kanë arritur të akumulojnë pikët e nevojshme në provimin pranues për tu pranuar në nivelin master, Senati vendosi si qe të refuzohen ankesat e tyre si të pa bazuara;


Senati gjithashtu pas shqyrtimit të propozimit të komisionit për ankesa të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24 ref. nr. 3114/23, në Fakultetin e Arteve të dt. 30.10.2023, i cili pas rikontrollit të testeve ka konstatuar se kandidatja znj. Flutra Kasapolli, ka arritur të akumuloj 68 pikë, pikë këto të mjaftueshme për tu pranuar në drejtimin në të cilin ka aplikuar, vendosi të aprovoj kërkesën si të arsyeshme dhe bazuar.

Ndërsa për kandidatin z. Uran Abazi, komisioni i ankesave të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24, sipas propozimit ref. nr. 3114/23, të dt. 30.10.2023, ka konstatuar se kandidati ka arritur 48 pikë, pikë këto që nuk kanë qenë të mjaftueshme për tu radhitur në listën e studentëve të pranuar, prandaj Senati vendosi që të refuzoj ankesën si të pa bazuar.

T'i dërgohet;

- Parashtruesve të ankesave,
- Rektorit të UHZ – së,
- Prorektorës për çështje mësimore,
- Dekanit të Fakultetit Juridik dhe Arteve,
- Drejtorit për Çështje Studentore,
- Zyrës së IT-së,
- Arkivit

Kryesuese i autorizuar i Senatit
Prof. dr. Edmond Beqiri





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSHMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Ser. / No. 3201		Nr. /faq./ Bl. / str / flo. / pg 1	
Data / Datum / Date: 07.11.2023			

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 07.11.2023

Në bazë të vendimit nr. 3013/23, të dt. 16.10.2023, kushteve të konkursit për pranimin e studentëve në nivelin master ref. nr. 3046/23, të dt. 19.10.2023, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24, në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve të nivelit master, kundër rezultateve të shpallura më dt. 30.10.2023, në mbledhjen e mbajtura më dt. 07.11.2023, nxjerrë këtë:

PROPOZIM

Fakulteti Juridik

I. **Të Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatit z. Astrit Krasniqi, ref. nr. 753/23, kundër rezultateve të shpallura më dt. 30.10.2023, për pranimin e studentëve në nivelin master, drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane në Fakultetin Juridik, i cili ka kërkuar që të pranohet duke pretenduar se ka akumuluar pikë më shumë se sa ato të publikuara, por komisioni pas rikontrullit të testit konstaton se kandidati në provimin pranues ka akumuluar gjithsejtë 34 pikë, e është dashur të akumuloj 40 pikë për pranim, prandaj për këtë arsye komisioni propozon që të refuzohet ankesa;

II. **Të Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatës znj. Arlinda Krasniqi, ref. nr. 821/23, kundër rezultateve të shpallura më dt. 30.10.2023, për pranimin e studentëve në nivelin master, drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane në Fakultetin Juridik, e cila ka kërkuar që të pranohet duke pretenduar se ka akumuluar pikë më shumë se sa ato të publikuara, por komisioni pas rikontrullit të testit konstaton se kandidati në provimin pranues ka akumuluar gjithsejtë 27 pikë, e është dashur të akumuloj 40 pikë për pranim, prandaj për këtë arsye komisioni propozon që të refuzohet ankesa;

T'i dërgohet;

- Rektorit të UHZ – së
- Anëtarëve të Senatit
- Arkivit

Kryesuese e Komisionit
Prof. ass. dr. Alma Shehu Lokaj



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA ROSOVA ADMINISTRATA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3114	Nr. i Faq. / Et. str / No. pg 1	
Data / Datum / Datë: 30.10.2023		Pejë / Pej

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 23.10.2023

Në bazë të vendimit nr. 3013/23, të dt. 16.10.2023, kushteve të konkursit për pranimin e studentëve në nivelin master ref. nr. 2782/23, të dt. 27.09.2023, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në studimet Master në vitin akademik 2023/24, në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, pas shqyrtimit të ankesës/kërkesës të kandidatëve të nivelit master, kundër rezultateve të shpallura më dt. 13.10.2023, në mbledhjen e mbajtura më dt. 23.10.2023, nxjerrë këtë:

PROPOZIM

Fakulteti i Arteve

- I. Të Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e kandidatit z. Uran Abazi, ref. nr. 217/23, kundër rezultateve të shpallura më dt. 13.10.2023, për pranimin e studentëve në nivelin master, drejtimi Edukim Muzikor në Fakultetin e Arteve, i cili ka kërkuar që të pranohet nga radhët e komuniteteve pasi që i njëjti është kandidatë nga Preshave dhe ka nënshtetësi serbe, por komisioni pas rikontrollit të testit konstaton se kandidati në provimin pranues ka akumuluar gjithsejtë 48 pikë, sa i përket studentëve që vinë nga Preshava në konkurs nuk ka qenë e paraparë kuotë apo vend i rezervuar për këtë kategori të studentëve dhe për këtë arsye komisioni propozon që të refuzohet ankesa;
- II. Të aprovohet** kërkesa e kandidatës Flutra Kasapolli, ref. nr. 214/23, për pranimin në nivelin master, në drejtimin Edukim Muzikor në Fakultetin e Arteve, e cila ka kërkuar që të pranohet pasi që numri i kandidatëve që do të pranohen në këtë drejtim është 5, ndërsa në rezultate janë publikuar vetëm 4 kandidatë. Komisioni pas rikontrollit të testit konstaton se kandidatja ka akumuluar 68 pikë dhe propozon që e njëjta të pranohet në studimet master në drejtimin Edukim Muzikor në Fakultetin e Arteve.

T'i dërgohet;

- Rektorit të UHZ – së
- Anëtarëve të Senatit
- Arkivit

Kryesuese e Komisionit
Prof. ass. dr. Alma Shehu Lokaj